

Shora nje Kopje

Milqetim KASHI

25.07.2008



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETARE I UJIT  
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN - BUNE

Adresa: Qendra Transferimit te Teknologjive Bujqesore.Kati 3-te,Cel.0682081245

Nr. 360/1 Prot.

Shkoder,dt. 25.07.2008

INFORMACION

“MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJOR PERROI GOSKA E MADHE  
FSHATI FLET H/C FLET 2  
PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA  
SUBJEKTI “ADNAIN”

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga subjekti “ADNAIN” “per perdorim te burimit uJOR Perroi Goska e Madhe per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, dhe se propozimi i mesiperm, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune, nuk ka te beje me projekte, per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperm, vepra e marrjes se ujit ne Perroin Gocka e Madhe do te ndertohet ne kuoten 475 m mbi nivelin e detit. Ndertesa e centralit do te ndertohet ne afersi te fshatit Flet ne kuoten 308 m mbi nivelin e detit. Prurja mesatare shume vjecare ne akset e veprave te marrjes eshte  $Q = 2.9$  m<sup>3</sup>/sek..Subjekti kerkon te shfrytetoje nje prurje  $Q = 2.62$  m<sup>3</sup>/sek.

Subjekti gjate periudhes se veres nuk do pengojte vaditjen.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune Shkoder, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 “PER KONCESIONET”, dhe ne zbatim te tij te gernes b, pika 3, kreu IV, i V.K.M.-se nr. 87, dt. 16.01.2008, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007, te K.M., “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES  
DRIN-BUNE

SEKRETARI

Ing. Osman DELTINA

KRYETARI

Maxhid CUNGU

